

Konkluzione të Seminarit Kombëtar me temë:

**“Inovacioni dhe teknologjia e informacionit si mjet për përmirësimin dhe zhvillimin e metodave mësimore”**

Organizuar nga

Zyra Erasmus+ në bashkëpunim me grupin e Ekspertëve për Reformën në Arsimin e Lartë Shqiptar  
(HERE)

---

Zyra Erasmus + në Shqipëri në bashkëpunim me ekipin e Eksperteve të Reformës së Arsimit të Lartë HERE, zhvilloi në datën 8 Korrik 2016, në ambientet e Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, Seminarin kombëtar me temë *“Inovacioni dhe teknologjia e informacionit si mjet për përmirësimin dhe zhvillimin e metodave mësimore”*.

Prania e më shumë se 100 përfaqësuesve të stafeve akademike nga universitetet e vendit, bëri të mundur nxitjen e reflektimit dhe debatin mbi mundësitë dhe sfidat e përdorimit të inovacionit dhe teknologjisë së informacionit si mjet për përmirësimin dhe zhvillimin e mësimdhënies në Institucionet shqiptare të Arsimit të Lartë.

Gjithashtu të pranishëm në këtë seminar ishin edhe përfaqësuesja e Zyrës së Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri Znj. Xheni Sinakoli dhe eksperti i ftuar Prof. Dr Javer Vidal nga Universiteti i Lionit - Spanje.

Në përmbyllje të aktivitetit, bazuar në prezantimet e referuara, shqetësimet konkrete, debatet dhe diskutimet e zhvilluara, si dhe mendime konkrete të ardhura menjëherë pas aktivitetit, grupi organizator në mënyrë të përmbledhur listoi disa konkluzione dhe rekomandime në mbështetje të realizimit të këtij procesi të domosdoshëm.

1. Nisur nga fakti që Inovacioni në mësimnxënie dhe mësimdhënie është përcaktuar si faza tjetër e “Procesit të Bolonjës”, dhe bazuar në deklaratën e Konferencës Ministrore të Yerevan-it ku u përcaktuan angazhime të reja që kanë në fokus inovacionin në mësimdhënie dhe mësimnxënie përmes përdorimit të teknologjive inovative, është domosdoshmëri futja e ITC në IAL-të shqiptare për përmbushjen e Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë.

2. Angazhimi për shqyrtimin dhe transferimin e praktikave inovative të mësimdhënies dhe të mësimnxenies, kërkon një bashkëpunim të ngushtë me palët e interesuara, si dhe promovimin e këtyre praktikave brenda institucioneve të sistemit të arsimit të lartë.
3. Të synohet mësimdhënia inovative, realizuar me ndërveprimin mes "studentit" dhe "mjedisit të mësuarit", duke shfrytëzuar aftësitë e duhura dhe hartuar strategji, për aplikimin dhe përdorimin e teknologjive inovative si një mjet i favorshëm për zhvillimin e mësimin me një efikasitet më të mirë, gjë që nënkupton ndryshimet në njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e studenteve pas përfundimit të mësimin
4. Duke u ndalur në objektiva specifike, theksi vendoset në shkëmbimin e pikëpamjeve dhe eksperiencave në lidhje me mësimdhënien, duke ndryshuar rolin e mësuesit dhe studentit duke vendosur këtë të fundit në qendër.
5. Ndryshimi i rolit të pedagogut dhe studentit duhet të synojë bashkëpunimin mes tyre. Të mësuarit me pjesëmarrje aktive të studentit do ti japi atij një shans më të mirë për tu bërë i pavarur.
6. Aktualisht është domosdoshmëri përgatitja e studentëve (mësuesve të ardhshëm), dhe trajnimi i mësuesve me konceptin e vendosjes në qendër të nxënësit që në ciklin e ulët dhe atë të mesëm.
7. Gjykojmë të vlefshëm propozimin për të aplikuar ICT duke përzgjedhur disa fakultete / shkolla në gjithë Shqipërinë për një "case-control", duke vlerësuar disa indikatorë si: praktikitetin, zbatueshmërinë, pranueshmërinë, efikasitetin, inovacionin, rritjen e njohurive etj. Zbatimi i platformës moodle (<https://moodle.org>), është një shembull i thjeshtë dhe i suksesshëm për tu përdorur dhe zbatuar.
8. Në bazë të standardit 1.3, Institucionet e Arsimit të Lartë, duhet të sigurojnë se programet janë konceptuar në mënyrë të tillë që inkurajojnë studentët për të marrë një rol aktiv në procesin e të mësuarit, dhe se vlerësimi i studenteve pasqyron këtë qasje. Kjo indukon evidentimin e problemeve, përcaktimin e kritereve dhe formulimin e detyrave për

rishikimin e planeve mësimore, si një mënyrë që do të ndihmojnë në përputhjen e rezultateve dhe kompetencave të kërkuara.

9. Ngritja / plotësimi dhe forcimi i rolit të strukturave përgjegjëse për mësimin në nivel program studimi / departamenti / fakulteti dhe universiteti duhet të jetë i bazuar në partneritetin pedagog-student.
10. Forcimi i rolit të koordinatorit të programit të studimit dhe përcaktimi i stafit akademik të motivuar, është garantues i programit të studimit si dhe forcimit të sistemit të sigurimit të cilësisë edhe në implementimin e teknikave inovative të mësimdhënies.
11. Bashkëpunimi me tregun e punës dhe mundësia e ushtrimit praktik për rritjen e kompetencave individuale të studenteve, do të stimulojë motivimin dhe interesin e të mësuarit.
12. Përfshirja e biznesit dhe partnerëve sociale në mbështetje të universiteteve do të ndikojë në ngushtimin e hendekut të aftësive dhe kompetencave të studentëve. Kjo mund të konkretizohet përmes bashkëpunimit në mënyrë aktive në hartimin / zhvillimin e kurrikulave, programeve të përbashkëta studimore, bashkëpunimin për Edukimin e vazhduar si dhe bashkëpunimin me zyrat e karrierës.

Raportues :

Tiranë, 11. 07. 2016

Prof. Asoc Fatmira SHEHU